- 25.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

Neni 26 Modifikimi i Kontratës

- 26.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.
- 26.2** Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:
- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - b) Korrigjime në materiale
 - c) Korrigjime në sasi
- 26.3** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.
- 26.4** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

Neni 27 Zgjatja e afatit

- 27.1** Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

27.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

27.3 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Kontraktori ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë realizimin në kohë të punimeve objekt kontrate në përputhje me Nenin 5, Kontraktori njofton menjëherë Autoritetit Kontraktor me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Kontraktorit, Autoritetit Kontraktor vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Kontraktorit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

27.4 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 25, një vonesë nga Kontraktori në kryerjen e detyrimeve të përfundimit sipas grafikut të punimeve objekt kontrate do ta bëjë kontraktorin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likuajuara në përputhje me parashikimet në kontratë.

27.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 28 Ndërprerja e Kontratës

28.1 Njoftim për të korrigjuar

Nëse Kontraktori nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund ti kërkojë me Njoftim që të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

28. Ndërprerja për mospërmbushje

Autoriteti Kontraktor pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërbushje që i dërgohet Kontraktorit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;
- ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
 - c) Nëse provohet se Kontraktori është angazhuar në Praktika të Ndaluar, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

29. Ndërprerja për paftësi paguese

Autoriteti Kontraktor ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Kontraktorin nëse Kontraktori falimenton. Kontraktori ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Autoriteti Kontraktor nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Kontraktorin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenohet ose ndikohet në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Autoritetin Kontraktor

30 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- a) Autoriteti Kontraktor i mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- b) Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për ndërprerjen.
- c) Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktorin për të gjitha punimet që janë marrë në dorëzim përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktorit dëmet e shkaktuara Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktorit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 31 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 31.1** Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.
- 32.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

Shtojca 17**KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS**

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**1.1**Blerësi është: *[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]*

Adresa: _____

Telefoni: _____

Numri i faksit: _____

E-mail: _____

1.2Kontraktori është: *[vendos emrin e Kontraktorit]*

Adresa: _____

Telefoni: _____

Numri i faksit: _____

E-mail: _____

Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës.

1.31. Gjuha për komunikimet është *gjuha shqipe*:2. Gjuha është: *gjuha shqipe***Neni 2****Objekti i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt: **“Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara”**

Neni 3**Vlera e Kontratës**

Kontrata lidhet me një vlerë totale: _____

Neni 4 Sigurimi i Kontratës

4.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së saj) duhet të ofrohet nga Kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

4.2 Monedha do të jetë: **Lek**

Neni 5 Data e Fillimit

5.1. Kontraktori do t'i jepet leja për të hyrë në kantier mbas nënshkrimit të kontratës nga palet.

5.2. Në zbatim të nenit 43 pika 1/1 të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, kontraktori përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojë në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshme nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës). Një kopje të aplikimit duhet ta dorëzojë në Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave përpara fillimit të punimeve.

Neni 6: Afati i Kontratës

Afati maksimal i përfundimit të punimeve është **2 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

Neni 7: Drejtuesi i Projektit (Mbikqyesi i punimeve)

7.1 Mbikqyesi i punimeve do të jetë personi i përzgjedhur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me anë të një kontrate të vecante.

7.2 Detyrat e mbikqyresve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe detajohen në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit.

7.3 Në rast se mbikqyesi do të ndryshohet, Investitori njofton menjëherë Kontraktorin.

Neni 8: Lloji i Kontratës

Kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin në Njesi

Neni 9: Preventivi

9.1 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit me cmimin për njësi për secilin zë punimesh.

9.2 Për zërat e reja, të paparashikuara në Preventiv përveç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune, e cila i paraqitet Mbikqyresit të Punimeve nga Kontraktori. Mbikqyesi i punimeve mbasi ben kontrollin e analizes teknika ja con per miratim Autoritetit Kontraktor.

9.3 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

Neni 10

Situacionet

10.1. Kontraktori do t'i paraqesë Mbikqyrësit të Punimeve brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparshme, garancinë e difekteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

10.2. Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Kontraktori dhe do të vërtetojë shumën që duhet t'i paguhet Kontraktorit brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

10.3. Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompesuara pa prekur fondin rezervë, i cili do të financiohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

Neni 11: Garancia e Difekteve

Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës që do t'i mbahet nga çdo situacion kontraktorit si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe sanksionet e parashikuara në këtë kontratë.

Neni 12: Grafiku i Pagesës

12.1 Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor mbas firmosjes së situacionit nga Mbikqyrësi i Punimeve .

12.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda 30 ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga Mbikqyrësi i Punimeve.

12.3 Pagesat e situacioneve do të kryhen në numrin e llogarisë bankare të kontraktorit _____, në nr e llogarise _____

12.4. Pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 13. Personeli i Kontraktorit.

13.1 Kontraktori do të punësojë vetëm personelin e deklaruar në ofertë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve. Mbikqyrësi i Punimeve do t'i propozojë Autoritetit Kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor, vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontraktorit.

13.2 Në qoftë se Mbikqyrësi i Punimeve i kërkon Kontraktorit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Kontraktorit, duke theksuar arsyet. Kontraktori do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

13.3 Drejtor Teknik i Punimeve do të jete : _____

Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

- Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit;
- Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
- Korrespondencën zyrtare me Mbikqyrësin e Punimeve;
- Ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
- Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

13.4 Në rast se ndryshohet Drejtori Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyrësin e Punimeve i cili ve në dijeni Autoritetin Kontraktor.

Neni 14

Detyrimet e Sipërmarrësit

14.1 Sipërmarrësi do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuara, dhënë nga Autoriteti Kontraktor dhe në përputhje me K.T. të zbatimit të R.SH. – së

14.2 Drejtori Teknik i Punimeve në kantier, është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku do të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për zbatimin e projektit. Ky ditar në çdo kohë do t'i vihet në dispozicion Mbikqyrësit të Punimeve, grupit të Kolaudimit dhe Autoritetit Kontraktor.

14.3 Kontraktori ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Investitorit.

14.4 Kontraktori është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Abjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

14.5 Kontraktori është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

14.6 Kontraktori është i detyruar të pajisë punonjësit e tij në objekt me uniforma, në të cilat të jenë shprehur shenjat dalluese të shoqërisë Kontraktore.

14.7 Në rast të mosrespektimit të dispozitave të parashikuara në pikat e mësipërme Mbikqyrësi i punimeve i bën njoftim Kontraktorit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktori nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë Mbikqyrësi i punimeve i propozon Autoritetit Kontraktor aplikimin e penaliteteve në masën e caktuar në legjislacionin Shqiptar ne fuqi , penalitete te cilat do të mbahen nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.

Neni 15: Korrigjimi i Difekteve

15.1 Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Mbikqyrësi konstatohet një difekt Kontraktori është i detyruar ta korrigjojë atë brenda afatit që i lihet me shkrim, por jo më vonë se 15 ditë.

15.2 Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Mbikqyrësi i punimeve do të njoftojë Kontraktorin lidhur me çdo defekt para mbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret, por jo më shumë se 15 ditë.

15.3. Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim, si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij nëqoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

15.4. Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësisimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktorit, do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

15.5 Periudha e garancisë për difektet **është afati 24 muaj**. Me përfundimin e kësaj periudhe Kontraktori paraqet kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korrigjimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Nëse janë kryer gjithë korrigjimet e difekteve atëherë hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

Neni 16 :Defektet e Pakorrigjuara

16.1 Nëse Kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigojë. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Investitorit.

16.2 Në qoftë se Kontraktori nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar Investitori do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Sipërmarrësi do të paguajë këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Investitori do të mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.

16.3 Nëse me përfundimin e periudhës së garancisë Kontraktori nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara, Autoriteti Kontraktor i zbrit nga garancia deri në konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.

Neni 17: Marrja në Dorëzim e Punimeve

17.1. Kontraktori pas përfundimit të punimeve njofton me shkrim Mbikqyrësin e Punimeve dhe Autoritetin Kontraktor. Nëse Mbikqyrësi nuk ka verejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Kontraktori pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraqet brenda 30 ditëve Mbikqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyrësi i Punimeve, mbas verifikimeve, brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij ia paraqet të gjithë dokumentacionin Autoritetit Kontraktor.

17.2 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe Mbikqyrësi i punimeve do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

17.4 Nëse Mbikqyesi i punimeve zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, Mbikqyesi i punimeve do t'i japi udhëzime me shkrim Sipermarresit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

17.5 Nëse Mbikqyesi i punimeve zbulon defekte në Punime, Mbikqyesi i punimeve duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

17.6 Mbas marrjes se gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit autoriteti kontraktor leshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të cilirojë garancinë e sigurimit të kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.

17.7 Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyesi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të vepres, objekt i kësaj kontrate.

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata,

Në vërtetë si [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 19

Draft i Marrëveshjes Kuadër (Ku përcaktohen të gjitha kushtet)

PER PUNË / MALLRA/ SHËRBIME

[Përdorimi i kësaj drafte marrëveshje është i detyrueshëm për të gjithë autoritetet kontraktore që do të përdorin Marrëveshjen Kuadër]

Nr . __

datë :

Kjo Marrëveshje është lidhur më [datë] ndërmjet [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor], këtu e tutje referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktorit] përfaqësuar nga [përfaqësuesi], këtu e më tej referuar si "Kontraktori".

Kontraktori, përmes ofertës së tij, me datë [data] pajtohet të realizojë punët, siç specifikohet në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular;
- Formularin e Deklarimit të Ofertës të paraqitur nga Ofertuesi;
- Specifikimet Teknike;
- Preventiv

Të gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura, si pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i Marrëveshjes Kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e mallrave / shërbimeve / punëve të mëposhtme.

[Përshkrim i përgjithshëm]

1.2 Marrëveshja Kuadër do të zbatohet duke dërguar ftesa për oferta tek Operatorët Ekonomikë, palë në marrëveshje, sipas nevojave të Autoritetit kontraktor.

1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime në çmimet për njësi, për shembull nëse Autoriteti Kontraktor vendos të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara të specifikuara dhe / ose nëse Autoriteti Kontraktor vendos të mos blejë cilëndo nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: _____

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimet për njësi për punë / mallra / shërbime përshkruhen në Listen e Çmimit të Artikujve sipas zërave te preventivit.

2.2 Çmimet për njësi do të jenë fikse dhe nuk do të ndryshojnë për porositë e bëra në bazë të kësaj Marrëveshje Kuadër.

Nënshkrimet dhe datat

Për Kontraktorin

Për Autoritetin Kontraktor

Emri:		Emri:	
Pozicioni:		Pozicioni:	
Firma:		Firma:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Shtojca 20**Draft Marrëveshja Kuadër (Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet)****PËR PUNËT/ MALLRAT / SHËRBIMET**

Emri i Autoritetit Kontraktor,

dhe

Emri i Kontraktorit

Bien dakord si më poshtë:

Të nënshkruajnë Marrëveshjen Kuadër për objektin: <shëno titullin> me numrin identifikues: <shëno numrin e prokurimit>

Neni 1 Objekti.

1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat që do të lidhen përmes procesit të Mini – konkurrimit vetëm midis Operatorëve Ekonomik që janë palë në këtë Marrëveshje Kuadër.

1.2 Kjo Marrëveshje Kuadër nuk është një kontratë në vetvete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen, bazuar në të.

1.3 Kontraktori është vetëm një prej palëve të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 2 Detyrimet e Palëve

2.1 Autoriteti Kontraktor, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë Kontraktuesit një "Ftesë për Ofertë" sa herë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime.

2.2 Kontraktori është i detyruar të paraqesë një Ofertë sa herë që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 3 Kontratat në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër

1.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkurrimit.

Neni 4 Procesi i mini-konkurrimit

4.1 Procesi i mini-konkurrimit do të zhvillohet me të gjithë operatorët ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër, kurdoherë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime nga ana e Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të rihapë konkurrimin në të njëjtat kushte ose kushte të tjera të përcaktuara në Ftesën për Oferta, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit.

4.3 Sa herë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime, Autoriteti Kontraktor përgatit Ftesat për Oferta dhe i dërgon ato te të gjithë Operatorët Ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër. Vlerësimi i Ofertave do të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Oferta.

Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër _____

Firmat dhe Data _____

Për Kontraktorin

Për Autoritetin Kontraktor

Emri:		Emri:	
Pozicioni:		Pozicioni:	
Firma:		Firma:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

SEKSIONI IV**Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Shtojca 21: Formulari i Ankesës pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Shtojca 22: Formulari i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Shtojca 23: Njoftimi i Kontratës së nënshkruar

Shtojca 24: Njoftimi i kontratës së nënshkruar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

Shtojca 25: Formulari i anulimit të procedurës

Shtojca 21**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Nuis/Nipt

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

E-mail

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën**1. Numri i referencës së procedurës/Lotit**

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje
paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje
paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga
procedurat e prokurimit të parashikuara në
LPP

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Shtojca 22**FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT
EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR
DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Paraqitja e argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar drejtuar:

Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i Operatorit/ëve Ekonomikë/Bashkimit të operatorëve ekonomikë

Emri i plotë i Operatorit Ekonomik/Operatorëve Ekonomikë (ju lutem shtypeni)

Nuis/Nipt

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

E-mail

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për dërgimin e këyre kundërshtimeve (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

2. Lloji i Procedurës

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje
paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje
paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader.

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

7. Ankesa që po shqyrtohet:

(emri i Operatorit ekonomik që ka paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi)

8. Data e Publikimit të Njoftimit të Fituesit

Data (viti/muaji/dita)

Seksioni III. Argumentat mbi ankesën e paraqitur nga Operatori/ët ekonomikë

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. Deklaratë e hollësishme e argumenteve mbi ankesën e paraqitur

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin argumentimet tuaja. Për çfarëdo arsye, specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ketyre srgumenteve. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Tenderit, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë nëse është e nevojshme.

3. Lista e informacionit konfidencial

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgojeni formularin e plotësuar të argumentimeve tuaja, si dhe të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**

Shënim: Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të LPP, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Operatorit /eve Ekonomikë

Shtojca 23

(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor)

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ueb-faqe _____

1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktor:

Institucion qendror

Institucion i pavarur

Njësia e Qeverisjes Vendore

Të tjera

1.3 Kategoria e Autoritetit Kontraktor:

Autoritet kontraktor që prokuron për nevoja të veta

Organ Qendror blerës

I deleguar

Të tjera

Seksioni 2. Objekti i Kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës / Lotit

2.2 Lloji i “Kontratës për punë publike”

**Realizimi
i
punimeve**

Projektimi dhe realizimi i punëve

2.3.1 Mënyra e prokurimit

**Punime me
matje**

Kontratë me çelësa në dorë

2. Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po

Jo

Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomik

Të gjitha kushtet janë të vendosura Po Jo

2.4 Përshkrimi i shkurtër i kontratës

2. Fondi limit _____

3. Burimi i financimit _____

4. Objekti i Kontratës _____

2.5 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i përfundimit:

Kohëzgjatja në **muaj** ose **ditë**

ose

Duke nisur // dhe përfunduar në //

2.6 Ndarja në LOTE:

Po

Jo

Nëse po, numri i LOTEVE:

2.7 Kontrata me nënkontraktim:

Po Jo

Seksioni 3. Procedura

3.1 Lloji i procedurës: E hapur e thjeshtuar

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Sipas rëndësisë: Çmimi pikët

etj. pikë

ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

3.3 Numri i ofertave të paraqitura:

Numri i ofertave të rregullta:

Seksioni 4 Informacion rreth Kontratës

4.1 Numri i kontratës: _____ Data e kontratës

4.2 Emri dhe adresa e Kontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Nipti _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ueb-faqe _____

4.2.1 Emri dhe adresa e nënkontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Nipti _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ueb-faqe _____

4.3 Vlera totale përfundimtare e Kontratës (përfshirë shumë, opsione dhe nënkontraktive):Vlera _____ Monedha _____
(pa TVSH)Vlera _____ Monedha _____
(me TVSH)**4.3.1 Vlera totale e nënkontraktimit: _____**Vlera _____ Monedha _____
(pa TVSH)Vlera _____ Monedha _____
(me TVSH)**4.4 Informacion Shtesë**_____

Data e dorëzimit të këtij njoftimi □□/□□/□□□□

Shtojca 24

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri _____

Adresa _____

Tel/Faks _____

E-mail _____

Ueb-faqe _____

2. Lloji i procedurës: _____**3. Objekti i kontratës** _____**4. Numri i referencës së procedurës / Lotit** _____**5. Fondi Limit**

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (përfshirë Lotet, opsionet dhe nënkontraktimin):Vlera _____
(me TVSH) Monedha _____

Vlera e nënkontraktimit _____ me TVSH Monedha _____

7. Data e nënshkrimit të kontratës

8. Emri dhe adresa e Kontraktorit / nënkontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Numri i NIPT-it _____

(Shtojce për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

Shtojca 25

Formulari i Njoftimit të Anulimit

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Lloji i procedurës: _____

3. Numri i Referencës se procedurës/lotit:

4. Objekti i Kontratës _____

5. Fondi Limit _____

6. Arsyet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 98, pika 1:

- a) ;
- b) ;
- c) ;
- ç) ;
- d) ;

Etj. _____

7. Informacion shtesë

Data e dorëzimit të këtij njoftimi